

DITARI MUJOR JANAR 2025



TIRANA TRAINING CENTER: NJË HAP PËR-PARA PËR INDUSTRIJË E KINEMATOGRAFISË

Në prani të Kryeministrit Edi Rama, është prezantuar projekti Tirana Training Center në bashkëpunim me Catalyst Story Institute.

Ky qendër synon të trajtojë deri në 400 studentë në aktrim, regji, skenar dhe animacion, duke krijuar një lidhje të fortë me industrinë ndërkombëtare.

Me mbështetjen e kompanive si HBO, Netflix dhe Disney, Shqipëria po pozicionohet si një qendër rajonale për industrinë kreative dhe kinematografike.

BONUSI I PRANVERËS, PËRFITOJNË 730,430 PENSIONISTË KINEMATOGRAFISË



Këshilli i Ministrave ka miratuar shpërndarjen e bonusit të pranverës për të gjithë pensionistët e vendit, duke synuar mbështetjen e shtresave më në nevojë. Me 10,000 lekë për ata me pension nën 20,000 lekë dhe 5,000 lekë për ata mbi këtë kufi, kjo masë synon lehtësimin e jetesës për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së tretë. Ky hap është një tjetër përpjekje për të përmirësuar mirëqenien sociale dhe për të garantuar dinjitetin e të moshuarve në Shqipëri.

PAKETA E MALEVE: NJË EPOKË E RE PËR ZONAT MALORE

Me miratimin e Projektligjit të "Paketës së Maleve", qeveria shqiptare synon të transformojë ekonominë malore përmes mbështetjes së veçantë në punësim, investime dhe turizëm të qendrueshëm. Ligji lehtëson procedurat për pronësinë dhe ndërtimin, stimulon investimet me politika fiskale dhe promovon zhvillimin ekonomik të këtyre zonave. Me këtë nismë, diaspora shqiptare inkurajohet të rikthehet dhe të investojë në vendlindje, duke nxitur një model të ri zhvillimi për rajonet malore të Shqipërisë.



VILA 31: NGA SIMBOL I IZOLIMIT NË QENDËR ARTISTIKE NDËRKOMBËTARE

Ish-rezidenca e një epoke të errët është transformuar në një qendër inovative artistike dhe kulturore në bashkëpunim me Fondacionin Art Explora.

Vila 31 do të mirëpresë deri në 20 artistë çdo vit, duke i ofruar atyre hapësira për krijimtari dhe ekspozim global. Kjo nismë e ripërcakton Shqipërinë jo vetëm si një destinacion turistik, por edhe si një qendër arti dhe dialogu kulturor në Ballkan.



LIGJI PËR NJOHJEN E VITEVE TË PUNËS I JEP ZGJIDHJE MIJËRA QYTETARËVE

Kuvendi ka miratuar një ligj të rëndësishëm që njeh periudhat e punësimit në ish-ndërmarrjet shtetërore dhe kooperativat bujqësore, duke zgjidhur përfundimisht një problematikë të trashëguar për mijëra qytetarë. Ky akt eliminon burokracitë dhe shpenzimet për qytetarët, që kanë hasur vështirësi në njohjen e viteve të punës për efekt pensioni. Me këtë ligj, mbi 30 mijë qytetarë çdo vit do të përfitojnë pensionin e plotë që u takon, pa nevojën e proceseve gjyqësore të gjata. Ky është një hap i rëndësishëm për të garantuar një sistem pensionesh më të drejtë dhe më të qëndrueshëm.



TRANSPARENCA DHE AKSESI I LIRË NË INFORMACION

Në një hap të rëndësishëm për transparencën, qeveria ka nënshkruar një udhëzim të ri për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik. Licencat e reja, të harmonizuara me standardet e BE-së, do të garantojnë siguri ligjore dhe lehtësi në përdorimin e të dhënave.

Të gjitha informacionet do të jenë të aksesueshme në portalin opendata.gov.al, duke fuqizuar qytetarët dhe komunitetin e biznesit me të dhëna të hapura dhe të besueshme.



MARRËVESHJA ME ZVICRËN: AFTËSI TË REJA PËR PUNËSIMIN E TË RINJVE

Në bashkëpunim me Ambasadën e Zvicrës, firmosëm marrëveshjen për fazën e tretë të projektit "Aftësi për Punë", një program që synon përmirësimin e arsimit profesional dhe përshtatjen e tij me tregun e punës.

Me këtë projekt, të rinjtë shqiptarë do të kenë më shumë mundësi për të fituar aftësi të reja dhe për t'u integruar në tregun e punës, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.





AFTËSIMI DHE PUNËSIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Në vitin 2024, 525 persona me aftësi të kufizuar janë punësuar përmes Zyrave të Punës në të gjithë vendin. Ky rezultat është pjesë e përpjekjeve për të integruar dhe fuqizuar këta individë në tregun e punës, duke ofruar shanse të barabarta për të gjithë. Portali i punësimit dhe shërbimet online kanë lehtësuar këtë proces, duke e bërë më të aksesueshëm dhe efikas integrimin e tyre në treg.

THESARET SHQIPTARE NË BUDAPEST: NJË KOLEKSION QË RILIND NË MUZEUN MARUBI



Një koleksion i rrallë prej 300 objektsh bizhuteri dhe veshjesh shqiptare, që ndodhet në Muzeun Etnografik të Budapestit, do të kthehet në vëmendjen e publikut shqiptar. Kjo pasuri kulturore, e përfituar në shekullin XX nga Palokë Laca, do të ekspozohet në Muzeun Marubi në qershor 2025, duke ofruar një mundësi të rrallë për të njohur mjeshtërinë dhe artizanatin shqiptar ndër shekuj.

KUVENDI MIRATON PROJEKTLIGJIN QË RRIET EKSPORTET SHQIPTARE

Kuvendi ka miratuar një projektligj të rëndësishëm për garantimin e vijueshmërisë së tregtisë së lirë midis Shqipërisë dhe partnerëve ndërkombëtarë, duke krijuar kushte më të favorshme për sipërmarrjet eksportuese. Ky akt ligjor synon të mbrojë stabilitetin e zinxhirit të furnizimit dhe të ndihmojë sektorët e industrisë, bujqësisë, tekstileve dhe mineraleve të depërtojnë më tej në tregjet europiane. Me eksportet që arritën në gati 4 miliardë euro në vitin 2024, objektivi i ri është arritja e një kuote rekord prej 5 miliardë eurosh, duke forcuar pozitën e Shqipërisë si një vend konkurrues në rajon.



PLATFORMA OBP: NJË EPOKË E RE PËR PROKURIMET PUBLIKE

Me regjistrimin e 210 operatorëve ekonomikë në platformën OBP, qeveria ka rritur ndjeshëm transparencën dhe efikasitetin në proceset e prokurimit publik.

Operatorët ekonomikë marrin njoftime automatike për procedurat e reja, duke krijuar mundësi të barabarta konkurrimi.

Kjo risi teknologjike synon të minimizojë burokracinë dhe të rrisë efektivitetin në sektorin e prokurimeve.



RIKUALIFIKIMI I KALASË SË ELBASANIT: NJË MAGNET I RI PËR TURIZMIN

Një kapitull i ri nis për Kalanë e Elbasanit me firmosjen e memorandumit të bashkëpunimit me AADF-në, duke hapur rrugën për projektimin e rikualifikimit të kësaj zone historike.

Projekti do të zhvillohet në dy faza, me synimin për ta shndërruar këtë lagje në një destinacion të rëndësishëm kulturor dhe ekonomik. Me një kombinim mes trashëgimisë, biznesit dhe turizmit, Kalaja e Elbasanit pritet të tërheqë më shumë vizitorë dhe të krijojë mundësi të reja për komunitetin lokal.



HAPET THIRRJA PËR GRANTE PËR NGJARJE KULTURORE DHE KRIJUESE 2025

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka hapur thirrjen për financimin e festivaleve, eventeve dhe panairove kulturore që pasurojnë kalendarin artistik të vendit. Mbështetja ndahet në tre kategori: ngjarje të mëdha me impakt kombëtar (fondi deri në 2.5 milionë lekë), aktivitete që ndihmojnë artin lokal (fondi deri në 2 milionë lekë) dhe evente të vogla komunitare (fondi deri në 1 milion lekë). Afati i aplikimit është 7 shkurt 2025 dhe projektet synojnë të fuqizojnë skenën e pavarur, të promovojnë talentet e reja dhe të rrjetëzojnë produktin kulturor shqiptar në industrinë kreative ndërkombëtare.



PËR HERË TË PARË: MBËSHTETJE PËR PROGRAMET KULTURORE TË ORGANIZATAT OJF

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka nisur për herë të parë një program mbështetjeje për organizatat kulturore, duke ofruar fonde për programet vjetore të tyre. Thirrja ndahet në dy kategori: OJF me përvojë të gjatë në fushën e kulturës (fondi deri në 4 milionë lekë) dhe organizata që zhvillojnë aktivitete kulturore dhe edukative në komunitet (fondi deri në 2.5 milionë lekë). Ky financim synon të forcojë skenën artistike dhe të promovojë trashëgiminë kulturore në Shqipëri. Aplikimet pranohen deri më 7 shkurt 2025, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.



SHQIPËRIA I BASHKOHET RRJETIT EVROPIAN TË INOVACIONIT DIGJITAL

Në Piramidën e Tiranës u prezantua projekti Digital Innovation Unit (DIU), një nismë e re e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me partnerë strategjikë si Protik, Bashkia e Tiranës, Bashkia e Korçës dhe Vodafone Foundation. Ky projekt synon të mbështesë SME-të dhe startup-et shqiptare në transformimin dixhital, me fokus në inteligjencën artificiale dhe sigurinë kibernetike. Përmes DIU, Shqipëria bëhet pjesë e Rrjetit Evropian të Qendrave të Inovacionit, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin teknologjik dhe rrjetëzimin ndërkombëtar.



TAKIMI I RADHËS I KOMITETIT DREJTUES TË PROJEKTIT TË PROGRAMIT EU4CULTURE, NDËRMJET MEKI-T, DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN DHE UNOPS

Diskutime mbi ecurinë e deritanishme dhe ngjarjet kyçe të 6 muajve të fundit ku mund u veçuan inaugurimi i Teatrit të Kukullave si dhe muzeu etnografik i Krujës dhe Kavajës. Deri më tani, kanë përfunduar punimet në 18 site kulturore dhe vijnë punimet për 5 të fundit. Edhe në këtë fazë të programit, diskutimet dhe koordinimet mes partnerëve kanë peshë të madhe në mbarëvajtjen e projekteve ku në fokus mbetet qëndrueshmëria e programit në tërësi por edhe shfrytëzimi maksimal i çdo siti në funksion të turizmit kulturor.

